



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 7 VIDEO nga sulmi me thikë i 18-vjeçarit ndaj 32-vjeçarit në Shkodër
- 2 paguar 2.9 mln €? Deputeti zero transparencë! Paralajmërohet padi në SPAK, Balla: Pastrim parash
- 3 Kush ia bleu 15 mln euro Agron Shehajit vilën që vetëm 4 vite më herët kishte Komisariatit nr.3 në Tiranë
- 4 U filmuan duke marrë para nga një shofer, AMP arreston 2 efektive policie të kërkojnë të ulin nga fronti Lionelin
- 5 Botërori 2026/ Dikur në radhë për të bërë foto me Messin, sot 'fëmijet' e Barcelonës luftës me Mbretërinë e Bashkuar! U vranë 910 ushtarë
- Argjentina rrezikon gjokë nga FIFA për banderolën 'Las Malvinas', historia e

Kronikë

I riu plagos me thikë 32-vjeçarin në Shkodër, i vëllai tenton të vrasë autorin, vihet në pranga! Arrestohet edhe 18-vjeçari e i ati (VIDEO)

Arvin Fregjaj e ka sulmuar Vildan Kepëcën në poliklinikën e qytetit dhe më pas është larguar. Fatmirësisht, i lënduari është transportuar në spital dhe ndodhet jashtë rrezikut për jetën.

VIDEO nga sulmi me thikë i 18-vjeçarit ndaj 32-vjeçarit në Shkodër

VIDEO nga sulmi me thikë i 18-vjeçarit ndaj 32-vjeçarit në Shkodër Report TV



Watch on

Redaksia 16 Korrik, 13:18 | Përditësimi: 16 Korrik, 20:44



Mesditen e sotme në ambientet e brendshme të poliklinikës së Shkodrës, 18-vjeçari Arvin Fregjaj plagosi me thikë 32-vjeçarin Vildan Kepëca. I plagosuri u transportua spital ndersa motivet e konfliktit ende s'janë bërë të qarta.

Sakaq, situata mori përmasa edhe më të medha. Sapo mësoi për plagosjen e të vëllait, 41-vjeçari Arben Kepëca mori pistoletën me fishek në fole u nis për të vrrarë 18-vjeçarin.

Falë reagimit të menjëhershëm të policisë, 41-vjeçari u arrestua si dhe u sekuestrua arma.

LEXO EDHE:

Abuzimi me çmimet e shezlongëve, bashkia Shkodër kontrolle në plazhin e Velipojës! Penalitete për bizneset që abuzojnë

Pak orë pas ngjarjes, Policia e Shkodres arrestoi autorin e dyshuar, Arvin Fregjaj. Në pranga ra dhe i ati, Agron Mehmeti, 41-vjeç, i cili dyshohet se bashkepunetoi me te ne krim.

Njoftmi i plotë i policisë:

Si rezultat i kontrolleve intensive, si dhe veprimeve hetimore dhe operacionale, të kryera nga specialistët për Hetimin e Krimeve të Rënda, në bashkëpunim me shërbimet e Komisarariatit të Policisë Shkodër, me qëllim ndalimin dhe nxjerrjen përpara përgjegjësisë penale, të shtetasve të përfshirë në ngjarjen e sotme, në lagjen "Vasil Shanto", u kapën dhe u vunë në pranga shtetasit:

-A. F., 18 vjeç, banues në Shkodër, për veprat penale "Vrasja me dashje", mbetur në tentativë, kryer në bashkëpunim, "Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta" dhe "Prishja e qetësisë publike";

-A. M., 53 vjeç, babai i 18-vjeçarit, banues në Shkodër, për veprën penale "Vrasja me dashje", mbetur në tentativë, kryer në bashkëpunim.

Nga hetimet dyshohet se këta shtetas, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, kanë plagosur me mjet prerës (thikë), në ambientet e Poliklinikës, shtetasin V. K., 32 vjeç, i cili është në kujdesin e mjekëve.

Në lidhje me këtë ngjarje, më herët, shërbimet e Policisë parandaluan një ngjarje kriminale duke arrestuar në flagrancë shtetasin A. K., 41 vjeç, vëllanë e shtetasit V. K.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 18:52 VIDEO nga sulmi me thikë i 18-vjeçarit ndaj 32-vjeçarit në Shkodër

VIDEO nga sulmi me thikë i 18-vjeçarit ndaj 32-vjeçarit në Shkodër Report TV



Watch on

Mesditen e sotme në ambientet e brendshme të poliklinikës së Shkodrës, 18-vjeçari Arvin Fregjaj plagosi me thikë 32-vjeçarin Vildan Kepëca.

Report Tv ka siguruar video nga momenti i sulmit me mjetin prerës. Në pamje, duket qartë thika që 18-vjeçari mban në dorë, dhe momenti kur 32-vjeçari bie në tokë nga goditja me armën e ftohtë.

I plagosuri u transportua spital ndersa motivet e konfliktit ende s'janë bërë të qarta.



K.M/Shqiptarja.com

P.J/E.H/Shqiptarja.com

TAG: vildan kepeca arben kepeca arvin fregjaj Shkoder plagosje me thike

Komento

Komente

Ndalohet treptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:

Si e vlerësoni vendimin e PD për të bojkotuar seancat plenare?

Të drejtë Të gabuar Nuk e di

SH

14 Korrik, 12:01

Lajme të tjera

- lu gjendën në banesë 4 armë zjarri dhe municion, arrestohet 21-vjeçari në Shkodër (VIDEO)

16 Korrik, 08:53
- Plagosja e 22-vjeçarit në Fushë-Krujë, arrestohet autori! I gjendet edhe thika me të cilën kreu krimin (EMRI)

14 Korrik, 10:10
- Sherr me thika mes të rinjve në Fushë-Krujë, 22-vjeçari përfundon te Trauma (VIDEO)

13 Korrik, 21:43
- Vrau bashkëshorten për xheloz, Gjykata e Shkodrës lë në burg 64-vjeçarin! Asnjë fjalë në seancë (VIDEO)

13 Korrik, 10:34
- Ura e Mesit në Shkodër mahnit turistët e huaj: Vendi më i bukur në botë, me njerëzit më të mirë (VIDEO)

Ergys Kavaja

12 Korrik, 14:21
- Ekzekutimi i 40-vjeçarit në Shkodër, policia sekuestron 25 gëzhoja në vendin e ngjarjes! Pista e hetimit, gjakmarrja (VIDEO)

Ergys Kavaja

12 Korrik, 10:21
- U quajt 'Ura e Vezirit', për nder të Mehmet Pashë Bushatit, historia e panjohur e urës së famshme që komunistët i vunë minat në '78-ën

Ali Hasani

12 Korrik, 09:57
- Shkodër/ 40-vjeçari vritet me armë zjarri brenda automjetit! Dyshime për hakmarrje, i vëllai në 2017-ën ekzekutoi Angjelin Shkambin për një borxh dhe çështje nderi

11 Korrik, 20:02
- Festa e Liqenit në Shkodër, natyrë, traditë e përvojë unike! Turistët e huaj: Shqipëria është një vend i mrekullueshëm

Ergys Kavaja

11 Korrik, 16:33
- Vrasja në Shkodër/ U grindën për celularin, Shtjefën Ziçi e qëlloi të shoqen për shkak të xhelozisë, nuk shfaq pendesë! Kamerat e sigurisë fiksojnë momentin para krimit

Ergys Kavaja

10 Korrik, 11:33
- Durrës/ 40-vjeçari plagos me thikë bashkëshorten, shpallet në kërkim

10 Korrik, 09:21
- Conference League/ Villaznia përmbys 2-1 Malishevën në ndeshjen e parë, Brdaric rikthehet me humbje në Shkodër


9 Korrik, 22:15

× [Sh] Lajmi i fundit

'Shkenca politike, por vendin ma zunë Zegjinetë', - Me pankarta dhe kapele, studentët 'diplomohen' në sheshin e protestës (VIDEOLAJM)

16 Korrik, 20:52





Lajmi i fundit



‘Shkenca politike, por vendin ma zunë Zegjinetë’, - Me pankarta dhe kapele, studentët ‘diplomohen’ në sheshin e protestës (VIDEOLAJM)

16 Korrik, 20:52

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

